



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2461/ 5 prot

Datë 31.10.2023

V E N D I M
Nr. 1102 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ANBIM” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79330-09-08-2023, me objekt “*Blerje materiale pastrimi*”, me fond limit 2.080.000. lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ANBIM” SHPK me Nipt. L81618008J
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kukës.
Adresa: Sheshi: Skenderbej, Lagjja Nr.5, Kukës.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 11.09.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-79330-09-08-2023, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.080.000. lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se në datën 29.09.2023, ka përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me rezultatet si më poshtë:

1. “ANBIM” SHPK	me ofertë	1.411.750	Lek pa TVSH	skualifikuar
2. “4 S” SHPK	“	1.422.750	“	kualifikuar
3. “I&V Company” SHPK	“	1.469.999	“	kualifikuar
4. “EUROMEGA 2010” SHPK	“	1.593.900	“	kualifikuar
5. “BIOTEK” SHPK	“	1.683.125	“	kualifikuar
6. “MURATI” SHPK	“	1.716.400	“	kualifikuar
7. “Albania Distribution Chemicals SHPK”	“	1.739.325	“	skualifikuar
8. Besim Kamberi	“	1.831.200	“	kualifikuar
9. “ATLANTIK 3” SHPK	“	1.877.600	“	kualifikuar
10. Herjol Xhagolli	“	1.897.500	“	skualifikuar

II.3. Në datë 29.09.2023 operatori ekonomik “ANBIM” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij, në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“OE nuk permbush piken 2.2/b (tek kriteret e vecanta te kualifikimit) te percaktuar ne DST, pasi bilanci financiar i vitit 2022 eshte i pakonfirmuar nga administrata tatimore”.

II.4. Në datën 02.10.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” në SPE si dhe në Buletinin Nr.84, datë 09.10.2023, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3477, datë 08.10.2023, dhe me nr. 2461/2023 prot., datë 09.10.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-79330-09-08-2023, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.080.000. Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2461/2 Prot., datë 09.10.2023, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Me shkresën nr..2461/3 datë 13.10.2023, me objekt: Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me shkresën nr. 96 prot., datë 23.10.2023, protokolluar me tonën me nr.2461/4, datë 25.10.2023 me objekt informacion, autoriteti kontraktor ka përcjellë vendimin e KSHA-së, me Nr 23, datë 23.10.2023.

II.9. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes si edhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin si vijon:

“OE nuk permbush piken 2.2/b (tek kriteret e vecanta te kualifikimit) te percaktuar ne DST, pasi bilanci financiar i vitit 2022 eshte i pakonfirmuar nga administrata tatimore”.

[... ANBIM ShPK mendon se me dokumentacionin e dorëzuar i përmbush dhe ka kapacitetet dhe mundësitë për përmbushjen me sukses të kontratës që mund të përfitojë nga Bashkia Kukës. OE Anbim ShPK ka dorëzuar të tre bilancet por në sistem bilanci i vitit 2022 nuk është me nënshkrimin e degës së tatimeve në Tiranë por ky bilanc është dorëzuar në tatime dhe një kopje është e bashkëlidhur me ankesën..... vërtetimi i xhiros i marrë nga dega tatimeve dhe bilancet e miratuara si edhe mospasja e një raporti negativ në bilance mendojmë që e plotësojnë më së miri kapacitetin financiar të shoqërisë “ANBIM” SHPK.

Shoqëria kërkon anulimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e tij si edhe kualifikimin e OE ANBIM ShPK....]

III.1.2. Referuar Dokumenteve të Tenderit, në shtojcën nr. 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2/b “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

b. Kopje e vertetuar te bilanceve te tre viteve te fundit (2020, 2021 dhe 2022 te paraqitur prane Administrates Tatimore te konfirmuar nga ky autoritet, ku te paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

III.1.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.1.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5. Referuar Nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 1 dhe pika 4, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që

të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

III.1.6. Referuar Nenit 41 “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare” të Ligjit Nr. 10091 datë.05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

III.1.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ANBIM” SHPK në përmbushje të kriterit, sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2020.
2. Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2021.
3. Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2022.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve, që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.9. Për sa i përket pretendimit të ankesës së operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, kriterëve për kualifikim të procedurës objekt-ankimi, si edhe referuar arsyes së skualifikimit, ku operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar, për shkak se si ofertues: *“Nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.b të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar”*.

Komisioni Prokurimit Publik konstaton se nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ankimuesi “ANBIM” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit 2.2/b, konstaton se ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e pikës 2.2/b si vijon:

1. Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2020. Vulosur nga ANBIM SHPK si edhe vulosur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

2. Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2021. Vulosur nga ANBIM SHPK si edhe vulosur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

3. Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2022. Vulosur nga ANBIM SHPK, fakt i pranuar edhe nga operatori ekonomik në ankesën e tij [*...OE Anbim ShPK ka dorëzuar të tre bilanci për vitet 2020, 2021 dhe 2022, ku bilanci financiar i vitit 2022 nuk është me nënshkrimin e degës së tatimeve në Tiranë por ky bilanci është dorëzuar në tatime dhe një kopje është e bashkëlidhur me ankesën....*]

Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit, si edhe nga verifikimet e dokumentacioneve të sipërcituara, Komisioni Prokurimit Publik vëren se operatori ekonomik “ANBIM” SHPK nuk ka përmbushur kriterin e kualifikimit të parashikuar në pikën 2.2/b të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar duke paraqitur Pasqyrat Financiare të viteve 2020, 2021 dhe 2022, ku bilanci financiar i vitit 2022 është i pakonfirmuar nga administrata tatimore”. Referuar vendimit të KSHA-së së autoritetit kontraktor, dokumentacioni i ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga parashtrimet e ankimuesit të paraqitura në ankesë dhe dokumentacioni shoqërues i ankesës, bashkëlidhur së cilës gjendet Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2022. nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve shoqëruar me dokument përcjellës nga DPT ku thuhet: *“... Në përgjigje të kërkesë tuaj ju vemë në dispozicion kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj në sistemin informatik tatimor për vitin 2022 dorëzuar elektronikisht me cështjen nr. E0001116441 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë më datë 13.07.2023...”* vihet re se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e përcaktuar më sipër, sepse dokumenti i lëshuar nga DPT dhe paraqitur nga Ankimuesi, duke dhënë indicie mbi plotësimin e kriterit në fjalë nga ana e tij dhe për t'a kthyer në vlerën e provës autoriteti kontraktor bazuar në nenin 92 pika 1 të *lex specialis* duhet të kërkonte sqarime nga operatori ekonomik ankimues apo edhe informacion nga DPT duke qenëse, dokumenti Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2022 është dokument zyrtar që lëshohet nga vetë institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në këtë rast autoriteti kontraktor me mosveprim ka shkelur nenin 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” Autoriteti kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes pa cenuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës

në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, t’i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë, në përmbushje të qëllimeve të *lex specialis* të parashikuara në nenin 2 të tij. Me mosveprim autoriteti kontraktor i ka cenuar operatorit ekonomik mundësinë për të shteruar të gjitha alternativat e vënies në dispozicion të dokumenteve provuese siç është në rastin konkret Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2022, ngarkuar në sistem, i cili do t’i krijonte një panoramë më të qartë autoritetit kontraktor mbi përmbushjen apo jo të kriterit më sipër, pasi autoriteti kontraktor të njihej dhe vlerësonte mbi përmbajtjen e plotë të dokumentacionit dhe vërtetësinë e tij. Duke qenë se autoriteti kontraktor referuar sistemit të prokurimit elektronik, informacionit të dërguar nga ai si pjesë e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe parashtrimeve të operatorit ekonomik ankimues, në kundërshtim me nenin 92, pika 1 të *lex specialis*, nuk i ka kërkuar sqarim operatorit ekonomik ankimues me qëllim që, për përmbushjen e kriterit më sipër të gjykonte mbi përmbajtjen dhe vërtetësinë e dokumentit Pasqyrat Financiare të periudhës tatimore 2022 të cilën operatori ekonomik ankimues e ka bashkëlidhur me ankesën e paraqitur, Komisioni gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe të tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-79330-09-08-2023, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.080.000. lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro

